



Republika e Kosovës

Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Sumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Departamenti shërbimeve këshillimore teknike
Department of Technical and Advisory Services
Departmend za tehničke i savjetodavne usluge



Shërbimi Këshillimor Bujqësor Rural i Kosovës
Kosovo Agriculture and Rural Development Advisory Services
Poljoprivredna Ruralna Savetodavna Služba Kosova

Rëndësia e analizave të tokës

Te nderuar fermer,

Jemi ne prag te fillimit te punëve përgatitore për mbjelljet pranverore, andaj qe te jeni te suksesshëm ne prodhimtarin tuaj si hap i parë dhe shumë i rëndësishëm është analizimi i tokës suaj.

Rendimenti për njësi të sipërfaqes tek kulturat bujqësore varet nga shumë faktorë sikurse janë:

- kultivarët me potencial gjenetik të lartë prodhues, (përzgjedhja e farës cilësore)
- faktorët agroekologjik
- faktorët agroteknik dhe
- **faktorët agrokimik.**

Me këtë mesazh ju informojmë qe është koha ideale qe te merren mostrat e dheut varësisht nga kulturat qe planifikoni te mbillni dhe ti dërgoni ne Institute kompetente për analizim. Pas analizës do te njoftoheni për gjendjen e tokës suaj dhe do te pranoni rekomandimet profesionale ne bazë te rezultateve.

Analiza e dheut behet në mënyrë që të testohet niveli i lëndëve ushqyese në tokë dhe të përmirësohet ekuilibri ushqyes i tokës duke shtuar plehra ose duke hequr sasinë e tepërt prej saj.

Ushqyesit parësor në plehra njihen si NPK dhe ato janë Azoti, Fosfori dhe Kaliumi

Secila prej këtyre lëndëve ushqyese luan një rol të rëndësishëm në bujqësi dhe prodhimin e bimëve.

Analizimi i tokës do te ju ndihmoj në:

- Përdorimin racional të plehrave kimike në lloj dhe sasi,

- Ndërmarrjen e masave përmirësuese për tokat me probleme, si reaksioni i tokës dhe kripëzimi,
- Në arritjen e efekteve më larta të plehrave në rendimente të kulturave bujqësore
- Në sigurimin e informatave të nevojshme për marrjen e vendimeve për mbjelljen e kulturave të ndryshme në tokat e analizuara, dhe
- Rritjen e rendimentit për njësi të sipërfaqes, nëse aplikoni rekomandimet e institutit në bazë të rezultateve të analizave.

Pse është e rëndësishme testimi i dheut për bujqësinë?

U jep informacion fermerëve për përbërjen kimike të tokës së tyre.

Fermerët e dinë sasinë e saktë të lëndëve ushqyese që duhet të aplikojnë, pasi niveli i lartë ose i ulët i plehrave mund të ndikojë negativisht në tokën e tyre, të lashtat, ujërat nëntokësore apo edhe ajrin.

Duke testuar tokën e tyre rregullisht fermerët prodhojnë më shumë, gjë që ndikon pozitivisht në të ardhurat e tyre dhe gjithashtu i ndihmon ata të menaxhojnë dhe përmirësojnë rendimentet e tyre, duke ushqyer më shumë njerëz.

Kush mund të ju përkrah në marrjen e drejt të mostrave?

Për metodën e marrjes së mostrave ju njoftojmë që mund të drejtoheni në Qendrat Informative Komunale për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, secili në komunën e vet tek këshilltarët komunal që janë pjesë e **Departamenti për shërbime këshilluese**.

Këshilltarët janë të pajisur me sonda për marrjen e mostrave të dheut, dhe janë të përgatitur përmes trajnimeve për ngritjen e kapaciteteve që janë zhvilluar në të kaluarën me këshilltar. Ata do të ju ndihmojnë dhe këshillojnë për metodën e marrjes së mostrave varësisht nga kulturat që planifikoni të mbillni.

Për informata shtesë dhe çdo gjë që lidhet me këshillat mund të drejtoheni në:

Departamenti i Shërbimeve Këshillimore dhe Teknike, MBPZHR

Rr. "Ukshin Hoti", ndërtesa e ish Ramiz Sadikut, nr 120 Kati III, Prishtinë – Kosova

Tel. 383- (0)3820038426